

V E N D I M
Nr.118, datë 19.3.1991

**PËR NDRYSHIMIN NË URDHËRESËN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.1, DATË
7.7.1989 "PËR ADMINISTRIMIN E KËRKESAVE PËR BANESA DHE PËR
SHPËRNDARJEN E TYRE"**

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.0.1989, neni 16 ndryshohet si vijon;

"sipërfaqet që lirohen nga sistemimi me banesë nga qendra e punës, mbeten në dispozicion të tyre për të sistemuar punonjësit e tjerë, duke bërë propozimet në organet kompetente që merren me shpërndarjen e banesave, jo më vonë se 20 ditë para datës së lirim të banesës, kurse sipërfaqet që lirohen nga transferimi i punonjësve jashtë rrethit, mbeten në dispozicion të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve.

Sipërfaqet që lirohen nga sistemimi me banesë ose transferimi jashtë rrethit i ushtarakëve dhe i punonjësve të organeve e reparteve të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore e të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbeten në dispozicion të tyre për të sistemuar ushtarakët ose punonjësit e tjerë, duke bërë propozimet në organet kompetente që merren me shpërndarjen e banesave, jo më vonë se 20 ditë para datës së lirim të banesës.

Këshilli popullor i lagjes së qytetit ose këshilli popullor i qytetit, kur nuk është i ndarë në lagje, për banesat që lirohen marrin vendim jo më vonë se 10 ditë para datës së lirim të tyre".

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.460, datë 28.12.1990 "Për një ndryshim në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.7.1989 "Për administrimin e kërkesave për banesa dhe për shpërndarjen e tyre" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
FATOS NANO